



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË**

Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
Web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al

MIRATOHET:

REKTORI

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE

**PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
"MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË "SHKENCA
SOCIALE" ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR"**

**Dekani
Prof. Dr Gjergji Pendavinji**

**Përgjegjësi i Njesisë Bazë
Doc. Ardian Matka**

VITI AKADEMIK 2014-2015

1. EMËRTIMI I PLOTË I PROGRAMIT TË STUDIMIT:

“MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”

2. VENDIMET E ORGANEVE PËRGJEGJËSE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT:

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, 36 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës;

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1337, datë 10.10.2008, për kuotat e pranimit të institucioneve publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009;

Urdhëri Nr. 308, dt. 14.07.2014, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Një ndryshim në urdhërin Nr. 16, dt. 17.01.2012, Për riorganizimin e Fakultetit të Mësuesisë në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë dhe në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë, ii), gërma “a)” e pikës 7, të ndryshojë si më poshtë:

“a)” Mësuesi për Arsimin e Mesëm në “Shkenca Sociale”

Këshilli i Fakultetit _____

Vendimi Nr. 16, datë 05.07.2010, i Senatit Akademik të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, për hapjen e programit “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”.

3. OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MUNDËSITË QË AI I OFRON STUDENTIT PËR PUNËSIM

Synimet kryesore të programit studimit “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR” janë:

- të përgatitë mësime të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale dhe cilësi të larta morale dhe shoqërore për t’u kthyer në modele frymëzuese dhe motivuese për nxënësit;
- të përgatitë mësime të suksesshëm si njerëz të aftë për të punuar dhe për të ndihmuar në komunitet;
- të përgatitë mësime të suksesshëm të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë për të ndihmuar në zhvillimin e tyre.

Këto synime do të sendërtohen në disa objektiva të përgjithshme që ka ky program studimi, si:

- t'u japë të diplomuarve arsimim dhe trajnim të mëtjshëm profesional në fushën e mësimdhënies;
- t'u krijojë studentëve një pamje të re për arsimin në Shqipëri, në përputhje me përvojën dhe konceptet evropiane;
- të përpiqet për të realizuar një status të ri të mësuesit në kushtet e reja ekonomiko-shoqërore që janë krijuar;
- programi do të shtrojë alternativa konkrete për zhvillimin e arsimit në bazë të strategjisë kombëtare dhe të japë ndihmesën e vet për hedhjen dhe konsolidimin e bazave për një arsim sa më profesionist.

Synimet dhe objektivat e mësipërme janë pasqyruar në të gjithë dokumentacionin e programit të studimit “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”

Synimi final i programit është që të përgatitë specialistë të zotë që të thithen nga tregu i punës, qoftë në sektorin shtetëtor, ashtu edhe në sektorin privat.

Programi i studimit “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR” suksesin e tij e bazon:

- ✚ në kompetencën e stafit akademik,
- ✚ në infrastrukturën moderne që është ngritur për këtë qëllim pranë Fakultetit të Fakultetit të Shkencave Naturore dhe Humane,
- ✚ në përvojën e fituar gjatë viteve në zhvillimin e programeve Master i Nivelit të Parë në Mësuesi, si dhe
- ✚ në përkushtimin e mësuesve mentorë të shkollave të qytetit të Korçës.

Objektiva formuese të disiplinave:

- Nëpërmjet lëndës së Kërkimit Shkencor studentët do të pajisen me metodologjitë e kërkimit dhe të hulumtimit shkencor, çka do të bëjë që ata të jenë në gjendje të zbatojnë kërkimin shkencor në klasat ku do të zhvillojnë mësim;
- Pajisja e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në mësimdhënie në shkollat 9-vjecare dhe të mesme, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grupmoshave, përparësitë e arsimit në

vendin tonë dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social në ndryshim të vazhdueshëm;

- Paraqitja dhe përpunimi i metodave dhe mënyrave të ndryshme të mësimdhënies për një mësim aktiv dhe gjithpërfshirës;
- Aftësimi i studentëve për zgjidhjen e situatave problemore në arsim në kontekste të ndryshme;
- Sigurimi i një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me mësimdhënien e gruplëndëve me synim zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve dhe edukimin e kompetencave specifike për secilën lëndë. Njohja me zhvillimet më të fundit në fushën e mësimdhënies së këtyre lëndëve dhe aftësimin e tyre për komunikimin dhe teknologjitë e informacionit bashkëkohor;
- Njohja me zhvillimet më të fundit në fushën e mësimdhënies së këtyre lëndëve dhe aftësimin e tyre për komunikimin dhe teknologjitë e informacionit bashkëkohor;
- Realizimi i përgatitjes profesionale të studentëve duke u përqëndruar në çështje të tilla si testimi, menaxhimi, strategjitë e të nxënit, punë kërkimore dhe të mësuarit për gjatë gjithë jetës;
- Zhvillimi i aftësive praktike dhe profesionale të studentëve duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të aftësive komunikuese në seminare dhe në praktikën mësimore të vëzhguar në shkollë;
- Një objektivi tjetër i rëndësishëm është që t'u jepet studentëve një përvojë profesionale në njohjen e institucionit arsimor për të cilin ata përgatiten, për mënyrën e komunikimit dhe menaxhimit të kiasës, në didaktikën e mësimdhënies, vlerësimin të nxënësve etj. Këtij qëllimi i shërben më së miri edhe ngritja pranë Fakultetit tonë e Qendrës së Ekselencës, e cila do të jetë një mbështetje e fuqishme për mësimdhënësit e ardhshëm;
- Veprimtaritë formuese didaktike dhe praktikat profesionale do të sigurojnë një kontakt të vazhdueshëm të studentëve me shkollën për të cilën ata përgatiten.

Aftësimi praktik i studentëve do të arrihet nëpërmjet:

- ❖ Praktikës mësimore në shkollat më të mira të qytetit nën drejtimin e mësuesve mentorë dhe pedagogët e Fakultetit me qëllim vënien në praktike të teorisë, të metodave dhe teknikave të mësimdhënies.
- ❖ Në fund të praktikës mësimore, studentët vlerësohen nga mësuesit mentorë dhe nga drejtorja e shkollës përkatëse ku kanë zhvilluar praktikën mësimore.

Objektivat për hartimin e tezës së diplomës:

- ✓ Në përfundim të studimeve çdo student paraqet një punë kërkimore në formën e një teze diplome me 10 kredite përmes së cilës synohet që studenti të zhvillojë aftësitë e konceptimit, të analizës dhe të interpretimit të një hipoteze, si dhe të shkrimit dhe të paraqitjes së saj.
- ✓ Zhvillimi i teknikave të kërkimit shkencor dhe nxjerrjes së informacionit të domosdoshëm në fushën e mësimdhënies.
- ✓ Njohja me metodologji të ndryshme kërkimore në fushën e mësimdhënies, përmes seminarit kërkimor.
- ✓ Zhvillimi i shprehive të mendimit kritik, si dhe të vlerësimit të të dhënave dhe informacionit në fushat specifike të interesave profesionale të studentëve të lidhura me mësimdhënien.
- ✓ Zhvillimi i shprehive dhe aftësive të transferueshme të nivelit më të lartë në kërkimin shkencor dhe interpretimin e të dhënave.
- ✓ Ndërgjegjësimi i studentëve në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të përgjegjësive të tyre personale në përfshirjen në punë të pavarur kërkimore-shkencore, si dhe vlerësimin kritik të informacionit dhe të dhënave.
- ✓ Nxitja e studentëve për të kryer punë kërkimore duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni (fjalorë, site interneti, periodikë, manuale didaktike etj.)

Tipologjitë e temave:

- **Tema metodike në mësimdhënien** e disiplinës përkatëse për mosha dhe klasa të ndryshme.
- **Tema në fushën e kërkimit** në lidhje me karakterin zbatues të një discipline.
- **Tema teorike krahasuese** në fushën e Mësimdhënies dhe të përvetësimit të disiplinës përkatëse.
- **Temë kërkimore në fushën e Edukimit** me të cilën lidhet disiplina përkatëse.
- Studenti duhet të përgatitë një punim me shkrim 50 faqe A4 në fushën e Mësimdhënies së disiplinës përkatëse për mosha dhe klasa të ndryshme, të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të gërshetojë fushën kërkimore-shkencore sipas programit të studimit që ai ka shlyer.

PROFILI PROFESIONAL DHE SEKTORËT E PUNËSIMIT

RESPEKTIV

Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin

Programi i studimit “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**” ka për qëllim të pajisë studentët me:

- kompetencë të lartë në zotërimin e disiplinave përkatëse;
- kompetencë për të dhënë mësim në kontekste të shumëllojshme, në arsimin publik dhe jopublik, me fëmijët dhe me të rriturit, si dhe për qëllime specifike;
- aftësi për përdorimin e teknologjive të mësimdhënies dhe teknikave të komunikimit;
- aftësi për të reflektuar në mënyrë kritike për praktikën e profesionit dhe për t’u përfshirë në punë kërkimore në fushën e mësimdhënies.

Mundësitë për punësim

- Studenti me formim të tillë mund të punojë si mësues i shkollave publike dhe jopublike;
- Studenti me formim të tillë mund të punojë si specialist pranë drejtorive arsimore rajonale etj.
- Studenti me formim të tillë mund të punojë në qendrat e kualifikimit të mësuesve sipas disiplinave përkatëse.

4. STRUKTURAT AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane
Strukturat e tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	<p>Ministria e Arsimit</p> <p>Bashkëpunimi i ngushtë midis Fakulteteve të Universitetit tonë, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, Fakulteti Ekonomik dhe departamenteve përkatëse të këtyre Fakulteteve</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës</p> <p>Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë</p>
Subjekte të tjera publike apo private.	

UNIVERSITETI FAN S NOLLI

5. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR” zgjat 1.5 vite akademike, 3 semestra, 45 javë mësimore, 90 kredite.

Konkretisht:

Kursi I

Nr	Disiplina Mësimore	Simboli	Sem	Orë	Kredite
1	Bazat Kulturore të Edukimit	A	I	38	3
2	Bazat Psikologjike të Edukimit	A	I	50	4
	a. Zhvillimi dhe të Nxënërit b. Të Menduarit kritik	B		38	3
3	Bazat Pedagogjike të Edukimit	A	I	50	4
	a. Metodatat e Mësimdhënies b. Kulturë Gjuhe	B		50	4
4	Metodat e Kërkimit në Edukim	C	I	50	4
5	Metodat e Mësimdhënies së Filozofisë	B	II	38	3
6	Metodat e Mësimdhënies së Psikologjisë	B	II	38	3
7	Gjuhë Angleze për qëllime specifike	E	II	38	3
8	Diskursi Filozofik Bashkëkohor	B	II	50	4
9	Edukim Qytetar Demokratik	C	II	50	4
10	BE dhe Politikatat e tij	C	II	40	4
11	Natyra Kulturore Historia	B	II	50	4
12	Politikat Urbane	B	II	40	4
13	Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit	D	II	38	3
14	Menaxhimi dhe Administrimi i arsimit	D	II	38	3

Kursi II

Nr	Disiplina Mësimore	Simboli	Sem	Orë	Kredite
1	Seminar Kërkimor për përgatitjen e Tezës	B	III	38	3
2	Metodat e Mësimdhënies së Sociologjisë	B	III	38	3
3	Komunikimi dhe hapësira Sociale	B	III	50	4
4	Trashëgimi Kulturore	B	III	50	4
5	Praktika Mësimore	E	III	150	12
6	Teza e Diplomës	F	III	125	10

Shënim:

1. Praktika profesionale zhvillohet e grupuar sipas një koordinimi të veprimtarisë me Drejtorinë Arsimore Rajonale Korçë, dhe të rretheve të tjera, kjo në përputhje me përkatësinë demografike të studentëve.
2. Nga 2 lëndë me zgjedhje studenti zgjedh lirisht një të prej tyre.

6. STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR PËR VITIN AKADEMIK 2013-2014

Tipi i veprimtarisë dhe simboli përcaktues për të	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite	Totali i krediteve
Disiplina të Formimit të Përgjithshëm (Bazë) (Simboli: A)	Bazat Kulturore të Edukimit Hyrje në Shkencat e Edukimit, menaxhimi i ndryshimeve individuale dhe në sistemin e edukimit	3	11
	Bazat psikologjike të Edukimit a. Zhvillimi dhe të nxënët	4	
	Bazat Pedagogjike të Edukimit a. Metodat e mësimdhënies	4	
Disiplina të Formimit Karakterizues të programit (Simboli: B)	Bazat psikologjike të Edukimit b. Të Menduarit Kritik	3	39
	Bazat Pedagogjike të Edukimit b. Kulturë Gjuhe	4	
	Metodat e Mësimdhënies së Filozofisë	3	
	Metodat e Mësimdhënies së Sociologjisë	3	
	Metodat e Mësimdhënies së Psikologjisë	3	
	Diskursi Filozofik Bashkëkohor	4	
	Natyra, Kultura dhe Historia	4	
	Politikat Urbane	4	
	Komunikimi dhe Hapësira Sociale	4	
Trashëgimi Kulturor	4		

	Seminar Kërkimor për përgatitjen e Tezës	3	
Disiplina Formuese të Ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese (Simboli C)	Metodat e Kërkimit në Edukim	4	12
	Edukim Qytetar Demokratik	4	
	BE dhe Politikat e tij	4	
Disiplina Formuese të Zgjedhura nga studentët (Simboli D)	Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit	3	3
	Menaxhimi dhe Administrimi i Arsimit	3	
Veprimtari Formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësinë informatike, praktika apo stazhe (Simboli E)	Gjuhë Angleze për qëllime specifike	3	15
	Praktikë Mësimore në Mësimdhënie	12	
Përgatitja e Tezës së Diplomës (Simboli F)	Teza e Diplomës	10	10

Gërmat A - F janë përdorur si simbole për veprimtaritë e ndryshme formuese në bazë të Udhëzimit Nr. 15. Datë 04.04.2008, “Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, Objektivat dhe veprimtaritë formuese të një programi studimi, pika 4, 5, “Për çdo program të caktuar studimi, objektivat formues përcaktues të programit dhe veprimtaritë formuese të domosdoshme për t’u ndjekur, grupohen si më poshtë”:

A→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash që lidhen me formimin e përgjithshëm (Bazë) për programin e studimit;

B→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash që karakterizojnë përkatësinë e programit të studimit;

C→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese që lidhen kryesisht me formime ndërdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike etj;

D→ Veprimtari formuese të zgjedhura nga studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit;

E→ Veprimtari formuese të parashikuara më sipër dhe të fokusuara drejt përfitimit të aftësive në gjuhën e huaj, aftësive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose përgjithësisht të aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës, sikurse edhe aktivitete formuese që lidhen me praktikat profesionale pranë kompanive të ndryshme, administratës publike, enteve private apo publike, urdhërave apo kolegjeve profesionale, bazuar në marrëveshje të përbashkëta për këtë qëllim;

F→ veprimtari formuese që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës.

Në programin e studimit parashikohen:

- | | | |
|-------------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| • leksione | × Po | <input type="checkbox"/> Jo |
| • ushtrime | <input type="checkbox"/> Po | <input type="checkbox"/> Jo |
| • laboratore | <input type="checkbox"/> Po | <input type="checkbox"/> Jo |
| • projekt/detyra | × Po | <input type="checkbox"/> Jo |
| • seminare | × Po | <input type="checkbox"/> Jo |
| • praktikë, stazh, etj, | × Po | <input type="checkbox"/> Jo |

7. TË DHËNA PËR PERSONELIN AKADEMIK QË MBULON DISIPLINAT E MËSIPËRME

Nr	Personeli akademik me kohë të plotë brenda Fakultetit	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Departamenti	Lëndët / Modulet përkatëse
1	Gjergji Pendavinji	Prof. Dr	FSHNH Dekani	Departamenti i Shkencave sociale	Diskursi Filozofik Bashkëkohor (Leksion) Metodat e Kërkimit në Edukim (Leksion)
2	Josif Minga	Prof. as	FSHNH	Departamenti i Shkencave sociale	Trashëgimi Kulturore
3	Ardian Matka	Doc	FSHNH Përgjegjës i Depart	Departamenti i Shkencave sociale	Metodat e Mësimdhënies së Sociologjisë Diskursi Filozofik Bashkëkohor
4	Magdalini Vampa	Dr	FSHNH Qendra e Ekselencës	Departamenti i Shkencave sociale	Bazat Kulturore të Edukimit Seminar Kërkimor për përgatitjen e tezës
5	Ina Zallëmi	Doktorante	FSHNH	Departamenti i Shkencave sociale	Metodat e Kërkimit në Edukim (Seminar)
Nr	Personeli akademik me kohë të plotë jashtë Fakultetit	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Departamenti	Lëndët / Modulet përkatëse
1	Aleksandra Piluri	Prof. as Dr	FFE	Departamenti i Edukimit	Zhvillimi dhe të Nxënët
2	Ali Jashari	Prof. Dr	FFE	Departamenti	Të Menduarit kritik

	Evionda Pylli Migena Riza	Doktorante Msc	Dekani	i GJ-L	Kulturë Gjuhe
3	Donika Dardha	Doc	FFE Përgjegj e Depart	Departamenti i Edukimit	Metodat e Mësimdhënies
4	Lindita Kaçani	Msc	FFE	Departamenti i Gjuhëve të Huaja	Gjuhë Angleze për qëllime specifike
5	Bashkim Jahollari	Prof. as Dr	FFE Përgjegj i Depart	Departamenti i H-GJ	BE dhe politikat e tij Menaxhimi dhe Administrimi i Arsimit
Nr	Personeli akademik me kohë të pjeshme	Titulli apo grada shkencore	Institucio ni	Departamenti	Lëndët / Modulet përkatëse
1	Gjergj Sinani	Prof. Dr	FSHS UT	Departamenti i Filozofisë	Metodat e Mësimdhënies së Filozofisë Natyra Kultura Historia
2	Edmond Rapti	Prof. Dr	FSHS UT	Departamenti i Psik-Ped	Metodat e Mësimdhënies së Psikologjisë
3	Theodhori Karaj	Prof. Dr	FSHS UT	Dekani FSHS Tiranë	Edukim Qytetar Demokratik
4	Zyhdi Dervishi	Prof. Dr	FSHS UT	Departamenti i Sociologjisë	Komunikimi dhe Hapësira Sociale
5	Sulejman Muça	Dr	FSHS UT	Departamenti i Shken Pol	Politikat Urbane
6	Sotir Temo	Prof. Dr	FSHNH	Departamenti i Shkencave sociale	Komunikimi dhe teknologjia e Informacionit

8. PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT, CIKLI I DYTË “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, SHKENCA SOCIALE ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”, VITI AKADEMIK 2013-2014

Semestri I (i parë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprimtarisë	Kreditet	Leksion	Seminar	Laborator	Total	Semestri	Frekuentimi
1	Bazat Kulturore të Edukimit Hyrje në Shkencat e Edukimit, menaxhimi i ndryshimeve individuale dhe në sistemin e edukimit	DFPB (Simboli A)	3	25	13		38	I	I detyruar
2	Bazat Psikologjike të Edukimit a. Zhvillimi dhe të Nxënët	DFPB (Simboli A)	4	38	12		50	I	I detyruar
3	Bazat Pedagogjike të Edukimit a. Metodatat e Mësimdhënies	DFPB (Simboli A)	4	38	12		50	I	I detyruar
	Bazat Psikologjike të Edukimit b.Të menduarit kritik	DFK (Simboli B)	3	25	13		38	I	I detyruar
	Bazat Pedagogjike të Edukimit b.Kulturë gjuhe	DFK (Simboli B)	4	38	12		50	I	I detyruar
4.	Metodat e Kërkimit në Edukim	DFN (Simboli C)	4	25	25		50	I	I detyruar

	GJITHSEJ (Semestri i parë)	6	22	189	87		276	I	
--	--------------------------------------	----------	-----------	------------	-----------	--	------------	----------	--

Semestri II (i dytë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprimtarisë	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1	Metodat e Mësimdhënies së Filozofisë	DFK (Simboli B)	3	25	13		38	II	I detyruar
2	Metodat e Mësimdhënies së Psikologjisë	DFK (Simboli B)	3	25	13		38	II	I detyruar
3	Gjuhë Angleze për qëllime specifike	DF (Simboli E)	3	25	13		38	II	I detyruar
4.	Diskursi Filozofik Bashkëkohor	DFK (Simboli B)	4	25	25		50	II	I detyruar
5.	Edukim Qytetar Demokratik	DFN (Simboli C)	4	25	25		50	II	I detyruar
6.	BE dhe Politikat e tij	DFN (Simboli C)	4	20	20		40	II	I detyruar
7.	Natyra Kultura Historia	DFK (Simboli B)	4	25	25		50	II	I detyruar
8.	Politikat Urbane	DFK (Simboli B)	4	20	20		40	II	I detyruar
9.	Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit	DFZ (Simboli D)	3	25	13		38	II	Disiplinë me Zgjedhje

10.	Menaxhimi dhe Administrimi i Arsimit	DFZ (Simboli D)	3	25	13		38	II	Disiplinë me Zgjedhje
GJITHSEJ (Semestri i dytë)		9	35	215	167		382	II	

Semestri III (i tretë)

Nr	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim.	Kred	Leks.	Sem	Lab	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1	Seminar Kërkimor për përgatitjen e Mikrotezës	DFN (Simboli C)	3	25	13		38	III	I detyruar
2	Metodat e Mësimdhënies së Sociologjisë	DFK (Simboli B)	3	25	13		38	III	I detyruar
3	Komunikimi dhe Hapësira Sociale	DFK (Simboli B)	4	25	25		50	III	I detyruar
4.	Trashëgimi Kulturore	DFK (Simboli B)	4	25	25		50	III	I detyruar
5.	Praktikë Mësimore në Mësimdhënie	DF (Simboli E)	12	150				III	I detyruar
6.	Teza e Diplomës	(Simboli F)	10	125				III	I detyruar
GJITHSEJ (Sem i tretë)		6	36	375	76		451	III	

8.1 LËNDET DHE MODULET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Nr.	Lënda	Tipi i veprimtarisë	Kreditet	Leks	Sem	Lab	Totali	Jashtë auditor	Semestri	Departamenti
I	Bazat Kulturore të Edukimit	DFPB (Simboli A)	3	25	13	-	38	38	I	Shkencave Sociale
	Moduli 1: Hyrje në Shkencat e Edukimit, menaxhimi i ndryshimeve individuale në sistemin e edukimit		3	25	13		38	38	I	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ	1	3	25	13		38	38	I	
II	Bazat Psikologjike të Edukimit	DFPB								Departamenti i Edukimit
	Moduli 1: Zhvillimi dhe të nxënët	(Simboli A)	4	38	12		50	50	I	Departamenti i Edukimit
	Moduli 2: Të Menduarit Kritik	(Simboli B)	3	25	13		38	38	I	Departamenti i Edukimit
	GJITHSEJ	2	7	63	25		88	88	I	
III	Bazat Pedagogjike të Edukimit	DFPB (Simboli A)								Departamenti i Edukimit
	Moduli 1:	(Simboli A)	4	38	12		50	50	I	Departamenti i Edukimit

	Metodat e Mësimdhënies									
	Moduli 2: Kulturë Gjuhe	(Simboli B)	4	38	12		50	50	I	Departamenti i Gj-L
	GJITHSEJ	3	8	76	24		100	100	I	
IV	Metodat e Kërkimit në Edukim	DFN (Simboli C)								Shkencave Sociale
	Moduli 1: Metodat e Kërkimit në Edukim		4	25	25		50	50	I	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ	4	4	25	25		50	50	I	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ SEM. I PARË	6	22	180	96		276	276	I	
I	Metodat e Mësimdhënies së Filozofisë									Departamenti i Filozofisë FSHS Tiranë
	Moduli 1: Metodat e Mësimdhënies së Filozofisë	DFK (Simboli B)	3	25	13		38	38	II	Departamenti i Filozofisë FSHS Tiranë
	GJITHSEJ	1	3	25	13		38	38	II	
II	Metodat e Mësimdhënies së Psikologjisë									Departamenti i Psiko-Pedagogjisë FSHS Tiranë
	Moduli 1:	DFK	3	25	13		38	38	II	Departamenti i

	Metodat e Mësimdhënies së Psikologjisë	(Simboli B)								Psiko-Pedagogjisë FSHS Tiranë
	GJITHSEJ	2	3	25	13		38	38	II	
III	Gjuhë Angleze për qëllime specifike									Departamenti i Gjuhëve të Huaja
	Moduli 1: Gjuhë Angleze për qëllime specifike	DF (Simboli E)	3	25	13		38	38	II	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
	GJITHSEJ	3	3	25	13		38	38	II	
IV	Diskursi Filozofik Bashkëkohor									Shkencave Sociale
	Moduli 1: Diskursi Filozofik Bashkëkohor	DFK (Simboli B)	4	25	25		50	50	II	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ	4	4	25	25		50	50	II	
V	Edukim Qytetar Demokratik									Departamenti i Filozofisë FSHS Tiranë
	Moduli 1: Edukim Qytetar Demokratik	DFN (Simboli C)	4	25	25		50	50	II	Departamenti i Filozofisë FSHS Tiranë
	GJITHSEJ	5	4	25	25		50	50	II	
VI	BE dhe Politikat e tij									Departamenti i H-GJ

	Moduli 1: BE dhe Politikat e tij	DFN (Simboli C)	4	20	20		40	40	II	Departamenti i H-GJ
	GJITHSEJ	6	4	20	20		40	40	II	
VII	Natyra Kultura Historia									Departamenti i Filozofisë FSHS Tiranë
	Moduli 1: Natyra Kultura Historia	DFK (Simboli B)	4	25	25		50	50	II	Departamenti i Filozofisë FSHS Tiranë
	GJITHSEJ	7	4	25	25		50	50	II	
VIII	Politikat Urbane									Shkencat Politike FSHS Tiranë
	Moduli 1: Politikat Urbane	DFK (Simboli B)	4	20	20		40	40	II	Shkencat Politike FSHS Tiranë
	GJITHSEJ	8	4	20	20		40	40	II	
IX	Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit									Shkencave Sociale
	Moduli 1: Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit	DFZ (Simboli D)	3	25	13		38	38	II	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ	9	3	25	13		38	38	II	

X	Menaxhimi dhe Administrimi i Arsimit									Departamenti i H-GJ
	Moduli 1: Menaxhimi dhe Administrimi i Arsimit	DFZ (Simboli D)	3	25	13		38	38	II	Departamenti i H-GJ
	GJITHSEJ	9	3	25	13		38	38	II	
	GJITHSEJ SEM II	9	32	228	167		395	395	II	
	Gjithsej Kursi I	15	54	408	263		671	671	I + II	
I	Seminar Kërkimor									Shkencave Sociale
	Moduli 1: Seminar Kërkimor për përgatitjen e tezës	DFN (Simboli C)	3	25	13		38	38	III	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ	1	3	25	13		38	38	III	
II	Metodat e Mësimdhënies së Sociologjisë									Shkencave Sociale
	Moduli 1: Metodat e Mësimdhënies së Sociologjisë	DFK (Simboli B)	3	25	13		38	38	III	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ	2	3	25	13		38	38	III	
III	Komunikimi dhe Hapësira Sociale									Departamenti i Sociologjisë FSHS Tiranë

	Moduli 1: Komunikimi dhe Hapësira Sociale	DFK (Simboli B)	4	25	25		50	50	III	Departamenti i Sociologjisë FSHS Tiranë
	GJITHSEJ	3	4	25	25		50	50	III	
IV	Trashëgimi Kulturore									Shkencave Sociale
	Moduli 1: Trashëgimi Kulturore	DFK (Simboli B)	4	25	25		50		III	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ	4	4	25	25		50	50	III	
V	Praktika Mësimore	DF (Simboli E)	12		150		150	150	III	Shkollat 9-vjeçare dhe Shkollat e Mesme, DAR Korçë
VI	Teza e Diplomës	(Simboli F)	10		125		125	125	III	Shkencave Sociale
	GJITHSEJ SEM III		36	100	351		451	451	III	
	GJITHSEJ Masteri		90	508	614		1122	1122	I+II+III	

9-14 DETYRIMET E MUNDSHME QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN

1. Hartimi i kësaj Rregulloreje është bazuar në ligjin nr. 9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në udhëzimin nr. 4, dt. 22.01.2008 “Për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të Master të Nivelit të Parë dhe të Dytë”, në udhëzimin nr. 15, dt. 15.4.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” etj.

Kjo Rregullore mësimore është bërë në përputhje me planin mësimor, duke respektuar liritë akademike, si dhe të drejtat e detyrat e personelit akademik dhe të studentëve.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje mësimore është që të mbështesë organizimin e programeve të studimit duke orientuar drejt studentët në mbarëvajtjen e studimeve.

Rregullorja specifikon aspektet organizative të programeve të studimit të ciklit të dytë në **Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë**, i cili ofron PROGRAMIN E STUDIMIT “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**”.

Përgatitja dhe zhvillimi i këtij programi studimi mbështetet në udhëzimet e Ministrisë të Arsimit nr.4, datë 22.1.2008, nr.15, datë 4.4.2008, dhe udhëzimin e datës 22.6.2010.

2. Ky Program Studimi zhvillohet pranë **Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, të Universitetit “Fan S.Noli” Korçë**.

3. Funkcionimin organizativ të këtij Programi e realizon Komiteti Shkencor i Programit.

4. Titujt i këtij Programi studimi jepen nga **Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë**.

5. Programi i studimit “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**” përfundon me titullin e diplomës: “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**”.

6. Studentët që zotërojnë një Diplomë të sistemit të vjetër ose Bachelor në lëndët e specialitetit, futen pa plotësim të njohurive formuese në Programin e studimit “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**”.

Për të gjitha diplomat e Ciklit të Parë ose diploma të tjera, të lëshuara nga Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Shqipërisë (analoge me ato të lëshuara nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, të Universitetit “Fan S. Noli”), bëhet vlerësimi rast pas rasti nga Komisioni vlerësues.

Shlyerja e njohurive formuese plotësuese nga Cikli I, bëhet gjatë semestrit të parë të programit të studimeve në “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**” sipas datave që do të caktojë dekanati në fillim të vitit akademik.

Në rast se numri i kërkesave të paraqitura i kalon kuotat e miratuara nga Fakulteti, do të zbatohen kritere të tjera specifike:

a. mesatarja (mesatarja 5 = 1 pikë, 5.1 = 2 pikë...10 = 50 pikë)

b. intervista

7. Pranimi i studentëve në “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR” bëhet në muajin shtator.

Kërkesat për pranim paraqiten pranë Sekretarisë së Fakultetit brenda datës 20 shtator. Brenda 1 jave nga afati i përfundimit të kërkesave, Komisioni vlerësues i fakultetit shqyrton kërkesat dhe jep vlerësimet përkatëse.

8. Studentët nuk mund të transferohen nga një universitet në tjetrin brenda të njëjtit program studimi në të njëjtin vit akademik.

9. Forma e studimit është me kohë të plotë. Format e provimeve janë provime me shkrim dhe me gojë, sipas programit të çdo lënde. Gjithashtu, për lëndë të caktuara, parashikohet verifikim i vazhdueshëm i njohurive si dhe vlerësim i njohurive përgjatë semestrit.

10. Programi i studimit “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR” ka 90 kredite. Studenti, i cili nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit përpara mbrojtjes së tezës së diplomës, nuk mund ta bëjë mbrojtjen. Vetëm pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet që parashikon programi, ai mund të bëjë mbrojtjen e tezës.

11. Studentët, të cilët kanë ndërprerë studimet dhe janë larguar për një kohë të pacaktuar, mund të paraqesin një kërkesë për ripranim përpara përfundimit të vitit akademik në vijim. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni vlerësues, i cili përditëson njohuritë e kandidatëve me ndryshimet që mund të ketë pësuar programi i studimit.

Edhe studentët që i kanë zgjatur studimet për më shumë se 1.5 vjet përtej kohës normale të fitimit të diplomës, para dhënies së tezës së diplomës, Komisioni vlerësues verifikon dhe vlerëson kreditet e fituara.

12. Programi i studimit “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR” do të zhvillohet në 1.5 vite akademike, i ndarë në tre semestra dhe përfundon me realizimin e 90 krediteve. Viti akademik është i organizuar në javë mësimore, javë provimesh dhe javë praktike e përgatitje për mbrojtjen e tezës së Diplomës.

Shlyerja e provimeve bëhet në 3 sesione: sesioni i dimrit (muajt janar-shkurt), sesioni i verës (muajt qershor-korrik), sesioni i vjeshtës (muaji shtator). Në sesionin e vjeshtës, studenti mund të shlyejë deri në 5 (pesë) provime. Në asnjë sesion nuk ka përmirësim note. Për mbrojtjen e tezës së diplomës janë 2 sesione: sesioni i dimrit dhe sesioni i verës.

Datat përcaktohen në çdo fillim të vitit akademik me vendim dekanati.

13. Studentët janë të detyruar të frekuentojnë 80% të orëve të mësimit në auditor dhe të praktikave profesionale. Në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi, studenti shpallet përsëritës për atë lëndë.

14. Plani mësimor përfshin disiplina të shkencave të edukimit dhe të kërkimit në edukim, disiplina formuese të zgjedhura nga studentët dhe disiplina formuese për përdorimin praktik të gjuhës angleze, aftësive komunikative, praktika profesionale dhe teza e diplomës, të cilat do të realizojnë 90 kredite apo përmbi 2250 orë pune për studentët që përfshijnë orët e planifikuara për leksione dhe seminare në auditor, orët për përgatitjen individuale të studentëve për seminarët dhe provimet, orët për kërkime në bibliotekë, si dhe orët e punës për praktikat profesionale, për hartimin e tezës së diplomës etj.

15. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane shpall Programin e Studimit “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**” në mjediset e Fakultetit dhe në faqen zyrtare të Universitetit për t’u njohur nga të gjithë kandidatët e interesuar.

16. Kandidatët për programin e studimit “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**” aplikojnë pranë Sekretarisë së Fakultetit sipas datave që shpallen në mjediset e Fakultetit dhe në Internet, duke përmbushur kriteret e pranimit.

17. Titullin e këtij Programi studimi e marrin studentët që kanë fituar 90 kredite nga plani mësimor i Programit dhe kanë marrë pjesë në masën 80 për qind në veprimtaritë mësimore profesionale.

18. Në përfundim të Programit të studimit “**MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR**” diplomantët realizojnë një provë finale në formën e mbrojtjes së tezës së diplomës, që vërteton aftësimin profesional dhe shkencor të studentëve.

Mbrojtja e Tezës së Diplomës bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim. Ky punim parakupton të përbëjë rezultatin e një studimi të thelluar të literaturës shkencore dhe vëzhgimi në praktikë, reflektimin e përvojës vetjake të fituar gjatë fëmijërisë teorik dhe praktik dhe dhënien e përfundimeve dhe të sugjerimeve mbi argumentin e përzgjedhur nga vetë studenti.

Tipologjitë e temave:

- A. Temë metodike në mësimdhënien e disiplinës përkatëse për mosha dhe klasa të ndryshme.
- B. Temë në fushën e kërkimit në lidhje me karakterin zbatues të një disipline.
- C. Temë teorike krahasuese në fushën e Mësimdhënies dhe të përvetësimit të disiplinës përkatëse.
- D. Temë kërkimore në fushën e Edukimit me të cilën lidhet disiplina përkatëse.

- Kriteret e hartimit të punimit për mbrojtjen e diplomës:

Punimi i diplomës në studimet master paraqet punën individuale të studentit i cili me anë të tij vërteton se aftësitë teorike të arritura gjatë periudhës së tij të studimeve, mund të shfrytëzohen me kujdes për zgjidhjen e problemeve praktike në fushën shkencore të programit mësimor. Me anë të punimit të diplomës studenti tregon se ka përvetësuar temën e dhënë, e ka punuar atë me metodën

që i përgjigjet punimit, një lëndën, terminologjinë dhe literaturën e përdorur profesionale dhe është i aftë ta citojë atë në mënyrë të rregullt.

Në punimin e diplomës duhet të dalë në dukje aftësia e të menduarit dhe e punës së pavarur të studentit, respektivisht aftësia për të nxjerrë përfundime dhe për të bërë propozime për zgjidhjen e problemit të caktuar.

- Pjesa e mikrotezës për diplomën “Master” duhet të ketë si rregull jo më pak se 40 dhe jo më shumë se 60 faqe kompjuterike të formatit A4. Referencat, shënimet në fund të faqes, shtojcat, tabelat, diagramet nuk përfshihen në këtë përlllogaritje. Numri maksimal i karaktereve në një faqe për punimin e mikrotezës është maksimumi 2000.

Vendi që zënë elementet e punimit:

- Hyrja 4-6 faqe
- Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes 7-8 faqe
- Trajtimi i çështjes dhe argumentimi i problematikës 20 – 30 faqe
- Përfundime - 4 -6 faqe
- Bibliografia

19. Të gjitha temat e diplomës së programit “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR” bëhen nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës. Të gjithë pedagogëve, me grada apo tituj, u lind e drejta të bëjnë udhëheqje të temave të diplomës për Programin “MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”. Gjithashtu, temat e diplomave kanë edhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.

Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin brenda muajit dhjetor të semestrit të parë të vitit të parë, të cilët firmosin një formular.

Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda afatit të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohet përfundimisht pranë Sekretarisë.

Për t’u pranuar në mbrojtjen e temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit **“MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”**.

Punimi dorëzohet në tre kopje dy javë përpara datës së mbrojtjes. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate ose nuk kanë marrë 90 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e dimrit. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar punimin dy javë përpara datës së mbrojtjes, studentëve u lind e drejta të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e verës.

19. Komisioni i vlerësimit të temave të diplomave përbëhet nga 3 (tre) pedagogë, prej të cilëve njëri është oponent dhe dy të tjerë duhet të jenë të fushës përkatëse. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh tre kritere:

- a) përmbajtja origjinale, dobia e punimit dhe zbatimi praktik;

b) mënyra e paraqitjes me gojë dhe

c) mesatarja e vitit të studimeve të Programit **“MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”**

20. Studentët që fitojnë në Programin e studimit **“MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”** paguajnë tarifën e përcaktuar të shkollimit me fillimin e vitit akademik.

21. Rezultatet dhe niveli cilësor i veprimtarive në Programin e Studimit **“MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”** vlerësohen çdo vit sipas modaliteteve të përcaktuara nga njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ky vlerësim bëhet i njohur për të gjithë.

22. Studentët që vazhdojnë programin **“MASTER PROFESIONAL, NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM NË “SHKENCA SOCIALE” ME PROFIL MINOR EDUKIM QYTETAR”** përfitojnë të gjitha të drejtat e shkollimit për Ciklin e Dytë të Studimeve në bazë të ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

15. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT

Sallat e leksioneve dhe të seminareve: Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane

Biblioteka: Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, Fakulteti Filologjisë dhe Edukimit

Sekretaria Mësimore: Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane

Departamenti: Shkencave Sociale

16. SYLLABUSET E LËNDËVE/ MODULEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

UNIVERSITETI FAN S. NOLLI